



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28 e datës 4 qershor 2008, dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 i datës 26.09.2008, Kryetari i Komunës merr:

VENDIM
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR IDENTIFIKIMIN E SIPËRFAQEVE -
HAPËSIRAVE PUBLIKE NË QYTETIN E LIPJANIT

Neni 1
Formimi i Komisionit dhe përbërja

Me këtë Vendim, formohet komisioni për identifikimin e sipërfaqeve - hapësirave publike në qytetin e Lipjanit, në vazhdim të tekstit Komisioni në këtë përbërje:

1. Driton Avdiu, Drejtorati për Inspektorat, Kryesues
2. Adem Kryeziu, Drejtorati për Shërbime Publike, anëtar
3. Besmir Retkoceri, Sektori për Tatim në Pronë, anëtar
4. Ramadan Hoxha, Sektori për Gjeodezi, anëtar
5. Gafurr Hetemi, Sektori pronësor -juridik, anëtar

Neni 2
Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit

Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit janë si vijon:

- a.) Të bëjë identifikimin dhe matjen e sipërfaqeve - hapësirave publike në qytetin e Lipjanit
- b.) Të bëjë identifikimin e shfrytëzuesve aktual të hapësirave publike
- c.) Të verifikojë në të gjitha rastet se të njëjtat a posedojnë leje përkatëse nga organet komunale
- d.) Në bashkëpunim me Drejtoratin për Shërbime publike dhe organet tjera komunale të vërtetojë se të njëjtat a kanë bërë pagesën e taksës konform Rregullores për Taksa Komunale.

Lidhur me detyrat e cekura në pikat a, b, c dhe d, Komisioni duhet të hartojë raport detal me shkrim për Kryetarin e Komunës më së largu me datë 29.07.2016

Neni 3
Hyrja në fuqi

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës ndërsa me kopjen e këtij Vendimi të njoftohen Kryesuesi dhe anëtarët e komisionit.

1Nr. 352-34236

Lipjan, më 29.06.2016

